

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri anëtarë, në çështjen juridike të paditëses NSHIMB “K..” në ..., e përfaqësuar prej AKP-së, zyra rajonale në Gjilan të cilën e përfaqëson Xh. S., nga ..., kundër të paditurit K. A., nga ..., për borxh duke vendosur përkitazi me revizionin e paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.4057/14 datë 10.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.12.2018 morri këtë :

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditëses paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në Prishtinë Ac.nr.4057/14 datë 10.09.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.4057/14 datë 10.09.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.49/2012 datë 25.09.2014 me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditëses NSHIMB “ K.” në ..., e përfaqësuar prej agjensionit kosovarë të Privatizimit zyra rajonale në Gjilan për kompensimin e dëmit në tëholla në shumë prej 25.000.00 DM në emër të blerjes së automjeteve të transportit si e pabazuar. Njëherësh është vendosur që se cila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i paditëses me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatë së shkallës së parë apo të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditëses të aprovohet.

I padituri ka paraqitur përgjigje në revizion duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruar në revizion , propozon që revizioni i paditëses të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e goditur dhe pretendimet e revizionit dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 215 të LPK-së gjeti se :

Revizioni i paditëses është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja ka paraqitur padi në gjykatë me datë 20.04.2004 ndaj të paditurit me kërkesë për kompensimin e dëmit në vlerë prej 12.500.00 €. Pretendon se i padituri gjatë mandatit të ushtrimit të punës dhe detyrave të punës Drejtor i NSHIMB “ K...” – Gjilan nga arka e paditësit ka tërhequr 25.000.00 DM në emër të blerjes së automjeteve transportuese pa vendim të organit kompetent të këshillit të punëtoreve. Kundër të paditurit është zhvilluar edhe procedura penale për shkak të veprës penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 paragrafi 1 të KPK-së, e cila ka përfunduar me refuzim të aktakuzës me aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr.110/2007 të datës 25 mars 2010. Kjo për arsye se nuk ka mundur të vërtetohet se paditësi ka bërë shpërdorimin e detyrës zyrtare përkatësisht tërheqjen e shumës së lartcekur për nevojat personale.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike e refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar për arsye se nga provat e prezantuara nuk është vërtetuar themelësia e kërkesëpadisë e duke u bazuar në nenin 319 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore në bazë të cilit parashihet që se cila palë ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Në rastin konkret pala paditëse nuk ka mundur të provoj faktet se i padituri ka përvetësuar shumen prej 12.500.00 € për çfarë arsye në mungesë të ekzistimit të provave e refuzon kërkesëpadinë si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë në këtë gjendje të çështjes drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësi është e pabazuar duke e refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës me të ulët në bazë të kësaj gjendje faktike kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale.

Aktgjykimi i goditur me revizion dhe ai i shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare. Gjykatat e instancës më të ulëte në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e paditëses në revizion se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulëte jon marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga se në revizion nuk ceket se me çka kanë të bëjnë këto shkelje. Në revizion përsëriten thëniet përkitazi me gjendjen faktike të cilat gjykatat e instance se më të ulët e kanë vlerësuar dhe për të gjitha këto kanë dhënë arsye në arsyetimin e aktgjykimit. Për më tepër kjo gjykatë shtonë se sipas nenit 214.2 të Ligjit të procedurës kontestimore revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plot të gjendjes faktike për deri sa revizioni në të vërtetë për këtë arsye i godet aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët duke potencuar se këto aktgjykime janë të bazuara në mos vlerësimin të drejtë të provave. Në të vërtetë pala paditëse duhet të provoj faktet në të cilat bazohet e drejta e saj përkatësisht bazueshmëria e kërkesëpadisë. Paditësi është i detyruar ta provojë ekzistimin e fakteve juridike në bazë të cilave e mbështet kërkesën e vet, por jo që kërkesa të bazohet në supozime. Kur gjykata në bazë të provave të administruar nuk mund të vërtetoj me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e fakteve të tilla do të konkludoi me zbatimin e rregullave mbi barrën e të provuarit. Prandaj në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike në procedurën e shkallës së parë, gjykatat e instancës më të ulëte drejt kanë zbatuar edhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëse është e pabazuar.

Nga sa u tha më sipër Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat është paraqitur revizioni dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.412/2018 datë 10.12.2018

Kryetar i kolegjit

Isa Kelmendi

